

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, i përberë kryetari i trupit gjykues gjyqtari Vesel Ismaili, me procesmbajtësen Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit nga për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.523/2016, të dt.30.11.2016, pas zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor fillestar, publikë e verbal në prezencën e Prokurorit të shtetit Ferdane Sylejmani, i akuzuari me mbrojtësin e tij av. nga i angazhuar sipas detyrës zyrtare, më dt.21.02.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

, i biri i dhe nënës e gjinisë i lindur me dt. në ku edhe tani jeton, në rrugën “ ” nr. , ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i shkurorëzuar, pa fëmijë, i gjendjes së dobët ekonomike, gjendet në vuajtje të dënimit për veprë penale të Vrasjes, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

Me datën 30.12.2015, rreth orës 18:05 në Qendrën Korrektuese në Lipjan, i akuzuari pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, ka mbajtur llojin e substancës narkotike të llojit "Marihuanë", që pas kontrollit nga ana e Oficerëve Korrektues në dhomën në shtratin e të pandehurit është gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike e lartcekur.

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 3, 4, 7, 17, 21, 41, 43, 45,46 ,73,74,75,76, dhe nenit 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së si dhe në bazë të nenit 359,361,365 dhe nenet 248 të KPPRK-së, **të akuzuarit i shqipton:**

DËNIM ME BURGË DHE DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, i shqipton dënim burgu në kohzgjatje prej **1 (një) viti**, të cilin dënim do ta vuan në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dënim me gjobë në shumë prej **500 (pesëqind) euro**, të cilën gjobë do ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftëse i akuzuari gjobën e shqiptuar nuk e paguanë në afatin e caktuar, dhe nëse nuk mund të ekzekutohet me detyrim, e njehta do t'i shëndrrohet në dënim burgu, duke ju llogaritur nga 20 (njëzet) Euro për një natë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguan shumë aq sa do të bëhet sipas fletëshpenzimores së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej **50 (pesëdhjetë) Euro**, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 62 par. 2 pika 2.7 të KPRK-së ndaj të akuzuarit Kadri Bajrami i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES

Konfiskohet substanca narkotike që përmban Kanabis (Marihuanë) Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme prej 0.07+0.0001n gram, si mjetë me të cilën është kryer vepra penale.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.L.nr. 523/2016, të datës 30.11.2016, kundër të akuzuarit _____ për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata zhvilloi shqyrtimin gjyqësor fillestar publik e verbal me datën 21.02.2018, dhe pas leximit të aktit akuzues nga prokurori i shtetit, i akuzuari u deklarua se në tersi e kam kuptuar aktakuzën, veprën penale për të cilën akuzohem, nuk kam nevojë për ndonjë sqarim shtesë, e ndjejë vetën fajtorë për kryerjen e kësaj vepre penale, nuk e kam të qartë as vetë pse e kam kryer këtë vepër penale, pendohem thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale apo çfarëdo qofshin ato, kam qenë i shtrirë në klinikën psikiatrike për afër 3 muaj, tani jam më mirë, andaj e lus gjykatën që të më shqipton një dënim sa më të butë të mundshëm ose dënim me kusht, pasi që më shkoj rinia në burg.

Mbrojtësi i të akuzuarit _____ av. _____ nga _____ i caktuar sipas detyrës zyrtare lidhur me pranim fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale thekson: duke pas parasysh se sot i mbrojturi im e pranoj fajësinë me vullnetin e tij të plotë, dhe pas konsultimit në masë të mjaftueshme me mua e duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale, i njëjti është penduar dhe i premtom gjykatës se më nuk do të kryej vepra të tilla, ngase siç deklaroi edhe vetë ka qenë në trajtim mjekësor, kërkoi prej gjykatës që ti shqipton një dënim sa më të butë, duke e përdor institucionet për zbutjen e dënimit siç janë dispozitat e nenit 75 dhe 76 të KPRK-së.

Prokurori i Shtetit Ferdane Sylejmani thekson: pasi janë plotësuar kushtet ligjore mbi pranimin e fajësisë jepi mendimin dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ngase i akuzuari ka pranuar akuzën e cila i vihet në barrë, ne rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ti vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe rënduese duke pasur parasysh edhe pranimin e fajësisë në seancë fillestare.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit përkitazi me veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Meqë i akuzuari në shqyrtimin fillestar gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me

dispozitën e nenit 248 par.1 të KPRK-së, ngase i akuzuari e ka kuptuar natyrën e veprës penale, bëni fitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i fajësisë është bërë në bazë

të vullnetit të tij dhe pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij av. se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që përmban akuza, të gjitha këto prova të siguruara gjatë procedurës hetimore siç është: raporti i ekspertimit AKF 2016-0359/2016-291, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, raporti i policit , foto albumi që të gjitha këto gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, mori mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit të cilën dhanë mendimin që të akuzuarit ti pranohet fajësia me që i njëjti pranimi fajësinë e bërë vullnetarisht dhe se përputhet me të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata konform nenit 248 par.1 të KPRK-së, mori aktvendimin me të cilin pranoi pranimin e fajësisë së deklaruar nga vet i akuzuari, me që pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata pasi i vlerësoj të gjitha provat materiale dhe ato formale një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe nga vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, e cila përcaktohet edhe nga përshkrimi ligjor i dispozitës 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Nuk është fare kontestuese që i akuzuari ka poseduar substancën narkotike në Qendrën korrektuese në Lipjan, gjegjësisht në dhomën e tij, që gjatë kontrollit nga ana e gardianeve janë gjetur substanca narkotike në shtratin e tij dhe i janë konfiskuar , e që janë realizuar në tiparet objektive dhe subjektive të kësaj veprë penale dhe atë duke u ndërlidhur me ekzistimin:

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin ,Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese ndaj të akuzuarit mori parasysh se i akuzuari është i moshës relativisht i ri, qëndrimin e tij korrekt në gjykatore, se gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shprehur keqardhje dhe pendim të sinqertë dhe real për veprimin e kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, por si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata mori parasysh pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale, kurse si rrethanë rënduese mori parasysh se i akuzuari edhe më parë është gjykuar dhe dënuar, intensitetin e lartë të rrezikimit të vlerave të mbrojtura siç është rrezikimi i jetës së njeriut me përdorimin e substancave narkotike të këtij lloji, shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, andaj gjykata të njëjtit i shqiptojë dënim me burg dhe dënim me gjobë si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar është në përputhje me peshën e rëndë të kësaj veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit , intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtit , si dhe do të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 34 të KPRK-së.

Konform nenit 450 dhe 453 të KPRK-së, gjykata obligoi të akuzuarin që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 €, dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale .

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPPRK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.720/16 dt.21.02.2018**

Procesmbajtësja
Nurije Rexhëbeqaj

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari
Vesël Ismaili

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.